VENDIM
Nr. 867, datë 30.9.2013

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 379, DATË 2.5.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E ZYRËS PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT, SI PËRFAQËSUESE NË KËSHILLIN ADMINISTRATIV TË FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR E PËRFITUESVE TË KËTIJ FONDI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 379, datë 2.5.2013 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorit, si përfaqësuese në këshillin administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor e përfituesve të këtij fondi".
2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama